



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BASHKIA PERMET**

*Tel & Faks: +355 813 22275; 22254*

*Email: bashkiapermet2015@gmail.com*

## **PROGRAMI I TRANSPARENCES PER BASHKINE PERMET**

Ne perputhje me nenin 7 te Ligjit Nr.119/2014 "Per te Drejten e Informimit" eshte pergatitur programi i transparences per Bashkine Permet. Ky program percakton kornizen ligjore te veprimtarise se autoritetit ne kuader te ligjit nr.119/2014 "Per te Drejten e Informimit"(LD I).

Ky program vleresohet si nje menyre konkrete permes se ciles Autoriteti Publik (ketej e tutje Bashkia Permet) nderton dhe rrit transparencen ne punen e tij institucionale, nen garancine e LDI-se.

Bashkia Permet do te perditesoje here pas here Programin e Transparences, ne perputhje me piken 2 te nenit 5 te LDI-se. Informacioni i bere publik ne kete program, synon te beje transparencen e veprimtarise se punes se Bashkise Permet, nepermjet pasqyrimet te detajuar te tij ne faqen zyrtare [www.bashkiapermet.gov.al](http://www.bashkiapermet.gov.al) . Programi i transparences pasqyrohet ne rubrika , tekste/permbajtje, afat kohor per berjen publike te tij, menyren e berjes publike si dhe strukturen perkatese e cila prodhon ose administron dokumentin.

Ne permbajtje te programit te transparences evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron ku adresohet dokumenti. Pervec kesaj, çdo dokument eshte i aksesueshem edhe ne skeme.

Dokumentacioni i bere publik, do te jete i perditeluar ne forme e permbajtje. Faqja zyrtare e Bashkise Permet eshte ndertuar ne ate forme qe mundeson informacion per publikun pa kerkese ne format lehtesisht te kuptueshem. Ne rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione qe karakterizohen nga kufizime te identifikimit te te dhenave personale per shkak te ruajtjes se privatesise se individeve/subjekteve te te dhenave, etj. Skema e publikimit paraqitet ndermjet tabelës permbledhese te evidentuar ne kete program.

## **II. PARIME TE PERGJITHSHME**

Parimet kryesore ne te cilat mbeshitet Programi Transparences se Bashkise Permet jane:

1. "E drejta per informim" eshte e drejte Kushtetuese e parashikuar ne nenin 23 te saj, e aksesueshme nga te gjithe pa asnje perjashtim.
2. Prezumimi i publikimit maksimal te te dhenave: Bashkia Permet ushtron funksione publike, per Rrjedhoje informacioni qe rrjedh nga veprimtaria e tij publikohet ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.
3. Zbatimi korrekt i ligjit dhe dispozitave ligjore qe rregullojne ne menyre te posacme veprimtarine e Bashkise Permet dhe perkatesisht: Ligji Nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" dhe Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
4. Informacioni pershtatet ne gjuhe te qarte e te kuptueshme.
5. Organ mbikeqyres i procedurave te informimit publik eshte Komisioneri per te Drejten e Informimit dhe Mbrojtjen e te Dhenave Personate".
6. Rishikimi i programit te transparences behet sipas se njejtes procedure, permes se ciles eshte bere miratimi i tij.
7. Informacioni publik pa kerkese duhet te jete:
  - i plote;
  - i sakte;
  - i perditesuar;
  - i thjeshte ne konsultim; i kuptueshem;
  - lehtesisht i aksesueshem;
  - i pajtueshem me dokumentet origjinale ne posedim te autoritetit publik.

## **III. INFORMACIONI QE BEHET PUBLIK PA KERKESE**

Informacioni i lejuar per publikim eshte shprehimisht i parashikuar ne nenin 7 te ligjit Nr.119/2014 "Per te Drejten e Informimit". Ne perputhje me kete program transparence te miratuar, Bashkia Permet vendos ne dispozicion te publikut ne faqen e tij te internetit [www.bashkiapermet.gov.al](http://www.bashkiapermet.gov.al) si dhe ne mjediset e pritjes se publikut, kategorite e meposhtme te informacionit:

- Strukturen organizative te Bashkise Permet ;
- Tekstet e plota, te ligjeve, te akteve nenligjore, ose ndonje dokument tjeter qe ka lidhje me ushtrimin e funksioneve te tij dhe qe prek publikun e gjere;
- Informacion per procedurat qe duhen ndjekur per te here nje kerkese per informim, adresen postare dhe elektronike per depozitim e kerkesave per informim, si dhe procedurat e ankimit te vendimit perkates;
- Te dhena per vendodhjen e zyrave te autoritetit publik, orarin e punes, emrin dhe kontaktet e koordinatorit per te drejten e informimit;
- Te dhena per arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionareve, te cilet kane detyrimin per deklarimin e pasurise, sipas ligjit, strukturat e pagave per nepunesit e tjere, si dhe nje pershkrim te procedurave te zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave te funksionareve te larte te autoritetit publik dhe proceduren qe ata ndjekin per te marre vendime;
- Mekanizmat monitorues dhe te kontrollit qe veprojne mbi autoritetin publik, perfshire planet strategjike te punes, raportet e auditimit nga Kontrolli i Larte i Shtetit

ose subjekte te tjera, si dhe dokumentet qe permbajne tregues te performances se autoritetit;

- Te dhena per buxhetin dhe planin e shpenzimeve per vitin financiar ne vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor per zbatimin e buxhetit. Ne ato raste kur autoriteti publik vetefinancohet nga tarifat e licencave ose çdo forme tjeter e financimit te drejtperdrejte nga subjektet e rregulluara prej tij, behen publike edhe dokumentet qe tregojne gjendjen e shlyerjes se detyrimeve nga subjektet e licencuara;
- Informacion per procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese te koncesionit/partneritetit publik privat , perkatesisht , sipas parashikimeve te ligjit nr. 9643, date 20.12 .2006, "Per prokurimin publik", dhe te ligjit nr. 125/2013, "Per koncesionet dhe partneritetin publik privat ", qe kryhen per llogari te autoritetit publik, duke perfshire: listen e kontratave te lidhura, shumen e kontraktuar , palet kontraktuese dhe pershkrimin e sherbimeve apo mallrave te kontraktuara, informacionin per zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhezues e politika te ndryshme;
- Informacion per sherbimet qe autoriteti i jep publikut, perfshire standardet per cilesine e sherbimit, nje pershkrim te kategorive dhe formave te ndihmes shoqerore, subvencionve te dhena nga autoriteti publik dhe te procedurave per t'i perfituar ato, informacione dhe dokumente qe kerkohen shpesh, çdo informacion tjeter qe gjykohet i dobishem nga autoriteti publik;
- Çdo mekanizem dhe procedure per berjen e kerkesave dhe ankesave, ne lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik, procedura , permes se ciles personat e interesuar mund te paraqesin mendimet e tyre apo te ndikojne ne çfare do menyre tjeter ne hartimin e ligjeve, te politikave publike apo ushtrimin e funksioneve te Bashkise Permet, nje pershkrim te thjeshte te sistemit qe perdor autoriteti publik per mbajtjen e dokumentacionit, te llojeve, formave te dokumenteve, si dhe te kategorive te informacionit qe behet publik pa kerkese;
- Bashkia Permet gjithashtu, krijon dhe arkivon nje kopje digjitale te faqes zyrtare te tij ne internet, te plotesuar me informacionin qe kerkohet ne programin e miratuar te transparences, si dhe per metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit te informacioneve publike, te cilat vihen ne dispozicion te publikut pa kerkese ;
- Aktet qe permbajne rregulla, norma apo kufizime te te drejtave dhe lirive themelore te individit, si dhe me efekt te drejtperdrejte per ta, behen publike me ane te afishimit brenda 48 oreve prej miratimit te aktit nga Bashkia Permet.

Informacioni i publikuar sipas kesaj skeme, perditesohet sa here ai ndryshon.

**TABELA PERMBLEDHESE E PROGRAMIT TE  
TRANSPARENCES PER BASHKINE PERMET**

Kategorite e informacionit publik pa kerkese	Baza ligjore	Dokumenti/Permbajtja	Afati kohor per publikimim	Menyra e publikimit	Sektori Pergjegjes per Pergatitjen e Materialit apo disponimin e tij
Perskrimi i struktures organizative, funksioneve dhe detyrave te Bashkise Permet	Neni 7/1/a/d	-Vendim i Keshillit Bashkiak -Organogram -Struktura e pagave -Te dhena per funksionet, detyrat, kompetencat te funksionareve te larte te Bashkise. -Te dhena per arsimin,kualifikimet dhe pagat e funksionareve te cilet kane detyrimin per deklarimin e pasurise. Pershkrim te procedurave te zgjedhjes.	Brenda 10 diteve nga miratimi nga prefekti          Perditesohet pas çdo akt emerimi	Ne faqen zyrtare te Bashkise Permet <a href="http://www.bashkiapermet.gov.al">www.bashkiapermet.gov.al</a> tek menu « Transparenca »	Zyra e Administrat Personelit
Ligje Akte nen ligjore Dokument tjeter	Neni/1/b          Neni 38/a i ligjit nr. 9887, date 10.03.2008 i ndryshuar	-Ligji Nr.139 date 17.12.2015 “Per veteqeverisjen vendore” -Ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, - Ligji 152/2013 “Për nëpunësin civil”, -Ligji Nr.146/2014 “Per njoftimin dhe konsultimin publik” Ligji 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, -Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë -Rregullore e brendshme - Ligje dhe akte te tjera nenligjore	Menjehere pas publikimit ne fletoren zyrtare	Ne faqen zyrtare te Bashkise Permet <a href="http://www.bashkiapermet.gov.al">www.bashkiapermet.gov.al</a> tek menu « Transparenca »	Zyra Juridike          Zyra e Administrat Protokollit          Kordinatori

Informacion per procedurat qe duhen ndjekur per te bere nje kerkese per informim, adresen postare dhe elektronike per depozitim e kerkesave per informim, si dhe procedurat e ankimit te vendimit perkates.	Neni 7/1/c/g	Ligji Nr.119/2014 “Per te drejten e informimit”  Format kerkese  Format ankese  Adrese postare: 6400 Adrese e-mail: bashkiapermet2015@gmail.com	Pas miratimit te Programit te Transparences . Menjehere ne rast ndryshimesh.	Ne faqen zyrtare te Bashkise Permet <a href="http://www.bashkiapermet.gov.al">www.bashkiapermet.gov.al</a> tek menu « Transparenca »	Zyra e Marredhenieve me Publikun dhe Informacionit
Te dhena per vendodhjen e zyrave te autoritetit publik, orarin e punes, emrin dhe kontaktet e kordinatorit per te drejten e informimit	Neni 7/1/ç	Informacion shpjegues lidhur me vendodhjen e zyrave te Bashkise Permet, orarin e punes, emrin dhe kontaktet e kordinatorit per te drejten e informimit	Pas miratimit te Programit te Transparences dhe urdhrimit te caktimit te kordinatorit	Ne faqen zyrtare te Bashkise Permet <a href="http://www.bashkiapermet.gov.al">www.bashkiapermet.gov.al</a> tek menu « Transparenca »	Specialisti i Komunikimit me Publikun
Pershkrimi i procedurave te zgjedhjes, kompetencave te funksionareve te larte dhe procedura e ndjekjes per marrjen e vendimeve.	Neni 7/1/d	Pershkrimi i procedurave te zgjedhjes, kompetencave te funksionareve te larte dhe procedura e ndjekjes per marrjen e vendimeve behet sipas Ligji Nr.139 date 17.12.2015 “Per veteqeverisjen vendore”	Menjehere pas botimit ne fletoren zyrtare.	Ne faqen zyrtare te Bashkise Permet <a href="http://www.bashkiapermet.gov.al">www.bashkiapermet.gov.al</a> tek menu « Transparenca »	Zyra Juridike
Mekanizmat, monitorues Raporte auditi Dokumentet me tregues performance	Neni 7/1/dh	Raporte auditi	Menjehere pas depozitimit ne institucion	Ne faqen zyrtare te Bashkise Permet <a href="http://www.bashkiapermet.gov.al">www.bashkiapermet.gov.al</a> tek menu « Transparenca »	Zyra e Administrates

Buxheti	Neni 7/1/e	Buxheti	Menjëherë pas shprehjes së ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut	Ne faqen zyrtare te Bashkise Permet <a href="http://www.bashkiapermet.gov.al">www.bashkiapermet.gov.al</a> tek menu « Administrata » Sektori Ekonomik	Sektori i Finances
Informacion per procedurat e prokurimit	Neni 7/1/ë	Ligji nr.9643, date 20.12.2006 “Per prokurimin Publik”; Regjister i prokurimeve publike	Menjhere pas dergimit ne APP	Ne faqen zyrtare te Bashkise Permet <a href="http://www.bashkiapermet.gov.al">www.bashkiapermet.gov.al</a> tek menu « Transparenca »	Njesia e Prokurimeve
Sherbimet e autoritetit per publikun	Neni 7/1/f	Informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut.	Menjhere	Ne faqen zyrtare te Bashkise Permet <a href="http://www.bashkiapermet.gov.al">www.bashkiapermet.gov.al</a> tek menu « Transparenca »	Zyra e Marredhenieve me Publikun dhe Informacionit
Paraqitja e mendimeve ne hartimin e p/akteve etj.	Neni 7/1/gj	Dokument shpjegues për mënyrën e paraqitjes së mendimeve në hartimin e ligjeve , te politikave publike apo ushtrimin e funksioneve te Bashkise Permet	Menjhere	Ne faqen zyrtare te Bashkise Permet <a href="http://www.bashkiapermet.gov.al">www.bashkiapermet.gov.al</a> tek menu « Transparenca »	Zyra Juridke Specialisti per Median Kordinatori
Mbajtja e dokumentacionit nga KDIMDP	Neni 7/1/h	Dokument shpjegues përmbledhës për mënyrën dhe llojin ne dokumentacionit që administrohet Bashkia Permet dhe mënyrën e shfrytëzimit të këtij dokumentacioni nga publiku.	Menjhere	Ne faqen zyrtare te Bashkise Permet <a href="http://www.bashkiapermet.gov.al">www.bashkiapermet.gov.al</a> tek menu « Sektori Juridik » Zyra Protokoll-Arkives	Kordinatori Zyra e Administrat Protokollit Specialist i Arkiv Protokollit

Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të ligjit nr.119/2014	Neni 7/1/i	Tabele  Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve sipas nenit 8 të Ligjit nr.119/2014.	Menjehere pas miratimit të programit të transparences	Ne faqen zyrtare të Bashkise Permet <a href="http://www.bashkiapermet.gov.al">www.bashkiapermet.gov.al</a> tek menu « Transparenca »	Kordinatori
Informacion dhe dokumente që kerkohen shpesh	Neni 7/1/k	Formular të ndryshem aplikimi	Menjehere	Ne faqen zyrtare të Bashkise Permet <a href="http://www.bashkiapermet.gov.al">www.bashkiapermet.gov.al</a> tek menu « Transparenca »	Kordinatori
Informacione të tjera të dobishme	Neni 7/1/l dhe shkronja « h » e nenit 31 të Ligjir nr.9887, date 10.03.2008, i ndryshuar	Ankesa Kerkesa Vendime të Keshillit Bashkiak  Njoftimet e punësimit me të dhëna sipas përcaktimeve të bëra nga Ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”; Materiale ndergjegjesuese dhe evente	Menjehere	Ne faqen zyrtare të Bashkise Permet <a href="http://www.bashkiapermet.gov.al">www.bashkiapermet.gov.al</a> tek menu « Transparenca »	Zyra e Marredhenieve me Publikun Zyra e Administrate Protokollit Specialisti për median Zyra Juridike Drejtorit perkatase sipas aktivitetetve që zhvillohen

## V. PUBLIKIMI

Në përputhje me këtë program transparence, Bashkia Permet vendos në dispozicion të publikut ne faqen e tij te internetit [www.bashkiapermet.gov.al](http://www.bashkiapermet.gov.al) dhe në mjediset e Zyrës kategoritë e mësipërme, në një menu të veçantë të titulluar “Transparenca”.

## VI. MONITORIMI

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, duke nxitur parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit. Komisioneri bën rekomandime për autoritetet publike, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës.